

SHOQATA E KONTABILISTËVE DHE FINANCIERËVE TË SHQIPËRISË

RREGULLORE
**PËR RREGULLAT E PËRGJITHSHME DHE TË PROCEDURËS SË INVESTIGIMIT
DHE DISIPLINËS**

Funksioni propozues	Këshilli Drejtues
Funksioni aprovues	Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve
Data e aprovimit	24.10.2020

I. HYRJE

1. Kjo rregullore miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.
2. Shoqata e Kontabilistëve dhe e Financierëve të Shqipërisë (në vijim SH.K.F.SH. ose “Shoqata”) synon të vërë në funksionim një sistem efikas investigimi dhe monitorimi të sjelljeve dhe veprimtarisë profesionale të anëtarëve, i cili garanton ushtrimin e profesionit të kontabilistit sipas standardeve teknike dhe etike më të larta nga anëtarët e Shoqatës.
3. Shoqata i qëndron parimit të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit të shërbimeve të kontabilitetit, si dhe të çdo subjekti tjetër që lidhet me këtë profesion, prandaj mbështet ngritjen profesionale të anëtarëve, promovon standardet më të larta të etikës profesionale, si dhe zbaton rregullat të përgjithshme dhe të veçanta mbi investigimin dhe disiplinën, të parashikuara në legjislacion, aktet rregullatore publike në Statutin e Shoqatës dhe në këtë rregullore, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve.
4. Kjo rregullore parashikon rregullat dhe procedurat për investigimin dhe disiplinën e zbatuar ndaj anëtarëve të Shoqatës, për fillimin e procedimit disiplinor, trajtimin e ankesave, plotësimin e tyre me provat e nevojshme, vlerësimin, njoftimin e subjekteve në ankesë, funksionimin e Komisionit Disiplinor, investigimin dhe zbatimin e kërkesave për investigim dhe paraqitjen e relacioneve dhe rekomandimeve pranë Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.
5. Termat dhe/ose shkurtime në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në Statutin e Shoqatës dhe Ligjin Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të miratuar”, ndërsa termat/shkurtime më poshtë kanë përkufizimet e përcaktuara respektivisht në vijim:
 - (i) **BMP:** Bordi i Mbikëqyrjes Publike.
 - (ii) **KIDB:** Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës së BMP.
 - (iii) **Komisioni Disiplinor:** Është Komisioni i Investigimit dhe Disiplinës së SH.K.F.SH. si Organizatë Profesionale e Kontabilitetit.
 - (iv) **Shkelje ose sjellje të papajtueshme (të gabuara ose të këqija):** Janë të gjitha ato shkelje që janë në papajtueshmëri me kuadrin rregullator në fuqi, duke përfshirë legjislacionin në fuqi dhe të gjitha aktet e dala në zbatim të tij, përfshirë edhe kuadrin rregullator të miratuar nga BMP. Më konkretisht, në këtë kategori do të përfshihet secila nga veprimet e mëposhtme:
 - a. Aktiviteti kriminal;
 - b. Veprimet ose mosveprimet, që ka të ngjarë të çojnë në diskreditimin e profesionit;
 - c. Shkeljet e standardeve profesionale;
 - d. Shkeljet e kërkesave etike;
 - e. Neglizhenca e madhe profesionale;
 - f. Neglizhenca profesionale, edhe pse më pak serioze, por që në mënyrë kumulative mund të tregojë për papërshtatshmërinë e të drejtave të ushtrimit të profesionit;

- g. Punën e pakënaqshme ose jobindëse;
 - h. Shkelje të kërkesave të rregulloreve, rregullave, vendimeve dhe të gjitha akteve të hartuara apo të miratuara nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
 - i. Shkelje të kërkesave ligjore.
- (v) **Subjekt i investigimit:** Janë të gjithë ato palë, të cilat janë subjekt i mbikëqyrjes së Bordit të Mbikëqyrjes Publike, që janë kontabilistë të miratuar, anëtarë të Shoqatës; shoqëri kontabilisti, anëtarë të Shoqatës; anëtarët e komisioneve, komiteteve dhe strukturave të tjera të SHKFSH, si dhe të gjithë ata individë apo subjekte që veprojnë ndesh me dispozitat e Ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe të Kontabilistit të miratuar” dhe rregulloret e BMP.
- (vi) **Investigim bazuar në ankesë:** Fillimi i një investigimi duke u bazuar në një ankesë. Ky lloj investigimi iniciohet nga BMP ose nga Shoqata, bazuar në një ankesë kundrejt një subjekti të investigimit. Zakonisht, ankesat paraqiten nga përfitues të shërbimeve të kontabilitetit ose nga një autoritet rregullator, por pa u kufizuar vetëm në to.
- (vii) **Investigim bazuar në informacione të tjera – jo ankesë:** Fillimi i investigimit mbi bazën e informacionit të marrë nga burime të sigurta, që tregojnë për mundësinë e sjelljes së keqe, edhe nëse nuk paraqitet ankesë siç përcaktohet në pikën 4 të Seksionit IV në këtë Rregullore.
- (viii) **Investigim me kërkesë të BMP-së:** Fillimi i investigimit dhe procesit disiplinor nga ana e Shoqatës kundër subjektit të investigimit, të iniciuara me kërkesë të BMP drejtuar Shoqatës.
- (ix) **Përpjekjet më të mira:** Një subjekt i investigimit ka bërë përpjekjet më të mira nëse në mënyrë të arsyeshme ai nuk mund të bënte më shumë për të përmbushur një detyrim të caktuar, që vjen si rrjedhojë e kuadrit rregullator.

II. BAZA LIGJORE DHE RREGULLATORE

1. Kjo rregullore është hartuar bazuar në **nenin 5, nenin 48, nenin 51, nenin 52, nenin 53** të Ligjit Nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar” të ndryshuar (në vijim “Ligji Për Auditimin”) dhe Rregullore nr.4, datë 29.03.2018 “Për investigimin dhe procedurat për marrjen e masave disiplinore” (në vijim “Rregullorja e Investigimit”).

III. QËLLIMI I RREGULLORES

1. Shoqata, nëpërmjet kësaj rregulloreje, synon të garantojë ushtrimin e profesionit të kontabilistit sipas standardeve teknike dhe të sjelljes etike të anëtarëve të Shoqatës dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit të shërbimeve të kontabilitetit si dhe të çdo subjekti tjetër që lidhet me këtë profesion.
2. Kjo rregullore ka për qëllim:

- a) zbatimin e kërkesave ligjore për investigimin dhe marrjen e masave disiplinore në përputhje me Ligjin për Auditimin dhe Rregulloren e Investigimit;
 - b) të vendosë rregulla dhe procedura për të garantuar të drejtat e palëve në procesin disiplinor;
 - c) të përcaktojë mënyrën e funksionimit të procesit të investigimit dhe dhënies së rekomandimeve për marrjen e masave disiplinore;
 - d) të vendosë parimet e përgjithshme dhe rregullat për funksionimin e Komisionit Disiplinor;
 - d) të përcaktojë rregullat që duhen ndjekur për investigimin e sjelljeve të gabuara të kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilistëve të miratuar dhe subjekteve të tjera të investigimit mbi bazën e informacioneve të besueshme dhe kuadrit rregullator në fuqi;
 - e) të përcaktojë rregullat që duhen ndjekur për marrjen e masave disiplinore ndaj kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilistëve të miratuar dhe anëtarëve kandidatë për kontabilistë të miratuar;
 - f) verifikimin e ankesave/kërkesave të paraqitura pranë Shoqatës nga BMP apo persona ose subjekte të tjera, duke siguruar kushtet e nevojshme për një investigim efikas dhe respektimin e të drejtave të palëve objekt ankese/kërkesë për investigim.
3. Kjo rregullore ka si synim të shërbejë si një udhëzues për subjektet e investigimit, lidhur me të drejtat e tyre dhe zbatimin e kërkesave të kësaj rregulloreje.

IV. SUBJEKTET E INVESTIGIMIT

1. Objekt i procedimit disiplinor janë ata anëtarë të Shoqatës, të cilët gjatë ushtrimit të profesionit:
 - a) kryejnë veprime të paligjshme ose aktivitet kriminal;
 - b) kryejnë veprime që çojnë në diskreditimin e profesionit;
 - c) shkelin standardet profesionale ose Kodin e Etikës së Shoqatës (në pajtueshmëri me Kodin e Etikës së IFAC);
 - d) shfaqin neglizhencë të madhe profesionale, duke dhënë shërbime kontabiliteti të gabuara, të papërshtatshme, me mangësi, me të meta të mëdha;
 - e) shkelin rregullat, vendimet dhe të gjitha aktet e hartuara apo të miratuara nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
 - f) kanë shkelur ligjin dhe/ose Statutin.

V. KOMISIONI DISIPLINOR

1. Misioni i Komisionit Disiplinor

- 1.1 Me qëllim zbatimin e rregullave dhe procedurave të vendosura në këtë rregullore dhe të tjera akteve rregullatore për qëllime disiplinore krijohet Komisioni Disiplinor pranë Shoqatës.
- 1.2 Qëllimi i përgjithshëm i Komisionit Disiplinor është të ruajë dhe garantojë standardet e domosdoshme për ushtrimin e profesionit të Kontabilistit të Miratuar dhe marrjen e masave disiplinore ndaj Kontabilistëve të Miratuar të anëtarësuar në Shoqatë, që shkelin rëndë ose në mënyrë të përsëritur dispozitat ligjore për ushtrimin e profesionit të Kontabilistit të Miratuar, Statutin dhe/ose Kodin e Etikës të Shoqatës.

2. Varësia e strukturës së Komisionit Disiplinor

- 2.1 Komisioni Disiplinor është strukturë në varësi të Këshillit Drejtues të SH.K.F.SH., që vepron në përputhje me parashikimet në këtë rregullore.

3. Emërimi dhe përbërja e Komisionit Disiplinor

- 3.1 Komisioni Disiplinor përbëhet nga katër anëtarë të Shoqatës “Kontabilistë të Miratuar”, të cilët emërohen nga Këshilli Drejtues për një periudhë trevjeçare, në përputhje me parashikimet e nenit 30 të Statutit të Shoqatës. Një nga anëtarët e Këshillit Drejtues mund të jetë edhe anëtar i Komisionit Disiplinor.
- 3.2 Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Disiplinor emërohen nga Këshilli Drejtues, duke u përzgjedhur ndërmjet Kontabilistëve të Miratuar, anëtarë të Shoqatës, që përmbushin kushtet për t’u zgjedhur si anëtarë të Këshillit Drejtues të SHKFSH.
- 3.3 Kryetari apo anëtarët e Komisionit Disiplinor nuk mund të jenë njëkohësisht anëtarë apo të mbajnë funksione në Komitete apo Komisione të tjera të SH.K.F.SH.

4. Përzgjedhja e Komisionit Disiplinor

- 4.1 Procedura e përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit Disiplinor fillon me njoftimin e vendeve vakante në faqen e internetit të Shoqatës.
- 4.2 Këshilli Drejtues fton anëtarët e interesuar dhe që plotësojnë kushtet e parashikuara në këtë rregullore, për të qenë pjesë e Komisionit Disiplinor, të shprehin interesin për t’u përzgjedhur duke paraqitur një kërkesë, drejtuar Kryetarit të Këshillit Drejtues dhe Drejtorit Ekzekutiv.

4.3 Afati për paraqitjen e kandidaturave përfundon pas një periudhe 21-ditore (kalendarike) nga data e shpalljes së njoftimit si në pikën 4.1 më sipër. Shprehja e interesit duhet të paraqitet brenda orarit zyrtar të punës së Shoqatës.

4.4 Këshilli Drejtues cakton me votim të thjeshtë aq kandidatë sa janë edhe vende vakante në Komisionin Disiplinor.

5. Përfundimi i mandatit të anëtarit të Komisionit Disiplinor

5.1 Funkzioni i anëtarit të Komisionit Disiplinor përfundon kur:

- përfundon mandati i tij;
- ndaj anëtarit është marrë masë disiplinore me pezullim për një periudhë kohe të caktuar;
- gjatë periudhës së mandatit lindin kushte papajtueshmërie me kërkesat statutoare apo të kësaj rregulloreje; ose
- jep dorëheqjen si anëtar i Komisionit Disiplinor.

5.2 Anëtarët e Komisionit Disiplinor mund të shkarkohen me vendim të Këshillit Drejtues në ato raste kur veprimet apo mosveprimet e tyre bien në kundërshtim me statutin, dispozitat ligjore apo në rastet kur kryhen shkelje të rënda dhe të përsëritura të rregulloreve të Shoqatës sipas gjykimit të Këshillit Drejtues.

5.3 Në rastet kur papajtueshmëria është e përkohshme, anëtari i Komisionit tërhiqet përkohësisht nga pjesëmarrja në Komision deri në momentin e ndërprerjes së kushteve të papajtueshmërisë, në përputhje me kërkesat statutoare dhe të kësaj rregulloreje.

6. Detyrat dhe kompetencat e Komisionit Disiplinor

6.1 Në përputhje me parashikimet në këtë rregullore, Komisioni Disiplinor shqyrton ankesat që i paraqiten për shqyrtim, duke vepruar objektivisht dhe pa u ndikuar nga funksione apo organe të tjera.

6.2 Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtë të shprehet mbi rastet sipas bindjes së tij. Në rast mosmarrëveshje, secili anëtar paraqet veçmas mendimet dhe vlerësimet e tij pranë Këshillit Drejtues, i cili merr vendimin përfundimtar në lidhje me çështjen.

6.3 Komisioni Disiplinor është përgjegjës për investigimin e ankesave dhe propozimin e masave disiplinore ndaj anëtarëve. Komisioni shqyrton ankesat e paraqitura ndaj anëtarit; Kontabilistit të Miratuar, shoqërisë së kontabilitetit të anëtarësuar në Shoqatë, apo ndaj çdo anëtari të veçantë.

6.4 Komisioni Disiplinor mund të fillojë edhe investigime bazuar në burime të tjera informacioni në përputhje me këtë rregullore.

7. Objekti i veprimtarisë së Komisionit Disiplinor

7.1 Veprimtaria e Komisionit Disiplinor ka si qëllim dhe përfshin:

- a) Investigimin e sjelljeve të këqija të Kontabilistëve të Miratuar (shkurtimisht “KM”), të shoqërive të kontabilitetit, të cilat iniciohen bazuar në informacione të besueshme të raportuara në SH.K.F.SH. ose përfshihen në programe që autorizohen nga Këshilli Drejtues.
- b) Shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga persona apo subjekte të tjera në SHKFSH dhe në BMP për Kontabilistët e Miratuar, shoqëritë e kontabilitetit dhe stazhierët/kandidatët për KM, anëtarë të Shoqatës.
- c) Investigimin e bazuar në autorizimin e Këshillit Drejtues, i rasteve të mosplotësimit të kushteve ligjore, rregullatore dhe të papajtueshmërisë të KM, shoqërive të kontabilitetit dhe të stazhierëve.
- d) Investigimin e bazuar në autorizimin e Këshillit Drejtues, i rasteve të mosdeklarimit të misioneve në pajtim me kërkesat statutoare e ligjore.
- e) Investigimi i atyre rrethanave që nga Këshilli Drejtues gjykohen se dëmtohet reputacioni i profesionit dhe i organizmit profesional.
- f) Raportimin e rezultateve të procedurave dhe konkluzioneve të arritura për çdo rast pranë Këshillit Drejtues të SH.K.F.SH.
- g) Përfaqësimi me autorizim të Këshillit Drejtues në BMP të rasteve të përcjella nga Këshilli Drejtues pranë BMP.

8. Funksionimi i Komisionit Disiplinor

- 8.1 Komisioni Disiplinor organizon dhe ndjek realizimin e proceseve investigative dhe për këtë qëllim mund të krijojë grupe pune teknike, që ai i gjykon të dobishme për të përmbushur objektin e investigimit. Në këto raste, Komisioni Disiplinor, nëpërmjet kryetarit të tij, i kërkon Këshillit Drejtues të SH.K.F.SH. të ftojë persona anëtarë të Shoqatës ose profesionistë të fushave të tjera specifike për të marrë pjesë në këto grupe pune për të vepruar si inspektorë në proceset investigative.
- 8.2 Për procedimet disiplinore të filluara dhe/ose në përfundim të investigimit për rastin përkatës, Komisioni Disiplinor mblidhet me kërkesë të Kryetarit, i cili kryeson të gjitha mbledhjet e Komisionit, dhe në mungesë të tij, mbledhjet drejtohen nga njëri prej anëtarëve të Komisionit Disiplinor.
- 8.3 Komisioni Disiplinor mund të marrë vendime të vlefshme kur në mbledhje janë të pranishëm jo më pak se gjysma e anëtarëve. Vendimet merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje. Në rast votash të barabarta, vota e Kryetarit është përcaktuese.

- 8.4 Në përfundim të procesit të investigimit, Komisioni Disiplinor rishikon evidencat e grumbulluara dhe merr vendime për rastin e shqyrtuar prej tij. Dosja me konkluzionet e arritura dhe masat e propozuara i dërgohet Këshillit Drejtues të SH.K.F.SH. jo më vonë se një javë kalendarike nga marrja e vendimit.
- 8.5 Vendimet e Komisionit Disiplinor pasqyrohen në një procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhjen përkatëse të Komisionit Disiplinor.
- 8.6 Procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit Disiplinor dhe i gjithë dokumentacioni që shoqëron praktikën investiguese ruhen në selinë e Shoqatës, në një ambient të dedikuar, që garanton sigurinë e informacionit, konfidencialitetin dhe ruajtjen e informacionit.
- 8.7 Kur autorizohet nga Këshilli Drejtues, Komisioni Disiplinor, nëpërmjet Kryetarit ose anëtarëve të tjerë, përfaqëson Shoqatën pranë BMP-së dhe autoriteteve të tjera sa herë është e nevojshme.
- 8.8 Komisioni Disiplinor ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm në përputhje me këtë rregullore për të marrë evidencën e duhur dhe dokumentacionin mbështetës të lidhur me rastin.
- 8.9 Në realizimin e detyrave të veta, Komisioni Disiplinor respekton afatet procedurale të parashikuara në këtë rregullore.

9. Shpërblimi i anëtarëve të Komisionit Disiplinor

- 9.1 Anëtarët e Komisionit Disiplinor dhe të angazhuarit në proceset investigative kanë të drejtën e shpërblimit dhe të rimbursimit të shpenzimeve në masën e përcaktuar nga Këshilli Drejtues.
- 9.2 Masa e shpërblimit është mujore dhe mund të ndryshojë në varësi të rasteve të shqyrtuara. Shpërblimi i kryetarit të Komisionit Disiplinor është më i lartë se ai i anëtarit të këtij Komisioni.
- 9.3 Ngarkohet Këshilli Drejtues i SH.K.F.SH., që, në varësi të rasteve të shqyrtuara, të përcaktojë masën e shpërblimit të Komitetit Disiplinor, të Kryetarit të këtij Komisioni dhe skemën e shpërblimit të personave të angazhuar në grupet e punës për investigimin e rasteve.

10. Detyrimi për të dhënë informacion

- 10.1 Të gjithë personat/shoqëritë që janë subjekte të investigimit sipas parashikimeve në këtë rregullore janë të detyruar të dorëzojnë pranë Komisionit Disiplinor informacionin e kërkuar brenda afateve të arsyeshme që vendos Komisioni në kërkesë.
- 10.2 Të gjithë personat/shoqëritë që janë subjekte të investigimit sipas parashikimeve në Ligjin për Auditimin dhe Rregulloren e Investigimit të BMP-së, janë të detyruar të dorëzojnë

pranë Komisionit të Investigimit dhe Disiplinës pranë BMP-së të gjithë informacionin e kërkuar Komisionit të BMP-së.

11. Pavarësia e personave përgjegjës për investigimin dhe disiplinën dhe shmangia e konfliktit të interesit

- 11.1 Anëtarët e Komisionit Disiplinor, që në fillim të çdo procesi investigimi, deklarojnë nëse janë të pavarur nga çështja/subjekti që investigohet dhe se nuk kanë asnjë marrëdhënie ekonomike apo familjare, të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, me subjektin e investigimit apo çështjen objekt investigimi apo kur marrëdhënia me subjektin e investigimit apo çështjen objekt investigimi është e tillë që anëtari, arsyeshmërisht, nuk mund të veprojë dhe të shprehet objektivisht në lidhje me rastin.
- 11.2 Nëse ekzistojnë kushtet e konfliktit të interesit si në pikën 11.1, Komisioni mban procesverbal të veçantë për përjashtimin e anëtarit në kushtet e konfliktit të interesit nga mbledhja dhe votimi për rastin përkatës.
- 11.3 Për të shmangur konfliktin e interesit, anëtarët e Komisionit duhet të konfirmojnë pavarësinë nga: (i) subjekti i kontrollit; (ii) personat e lidhur ose të interesuar me rastin e kontrollit.
- 11.4 Anëtarët e Komisionit, të cilët kanë marrëdhënie që përbën konflikt interesi, përcaktuar në pikën 11.1, nuk marrin pjesë në mbledhjen përkatëse dhe nuk kanë të drejtën e votës. Në këtë rast, kuorumi i nevojshëm për mbajtjen e mbledhjes së Komisionit plotësohet nëse të pranishëm në mbledhje janë dy anëtarë. Në rast se nuk plotësohet kuorumi i nevojshëm sipas kësaj pike për arsye që lidhen me konfliktin e interesit të anëtarëve, rasti shqyrtohet nga Këshilli Drejtues, i cili merr vendim për rastin.
- 11.5 Anëtarët e angazhuar në investigim si inspektorë në grupet e punës, të krijuar sipas pikës 8.1 të kësaj rregulloreje, duhet gjithashtu të plotësojnë kërkesat mbi pavarësinë dhe shmangien e konfliktit të interesit, që janë të zbatueshme për anëtarët e Komisionit Disiplinor dhe për këtë qëllim konfirmojnë që në fillim të çdo procesi investigativ se çdo anëtar i caktuar për të kryer apo ndihmuar një investigim është i pavarur nga çështja që investigohet dhe nuk është i lidhur apo ka interesa në çështjen që investigohet. Nëse ka konflikt që në fillim ose nëse konflikti lind gjatë investigimit, anëtari duhet të tërhiqet menjëherë nga investigimi i çështjes.
- 11.6 Në rast se zbulohen fakte apo rrethana që vërtetojnë konfliktin e interesit të anëtarit të Komisionit Disiplinor apo të çdo personi tjetër të referuar në pikën 11.4 dhe të përfshirë në procesin e investigimit, por që nuk janë vetëdeklaruar, atëherë Kryetari i Komisionit Disiplinor merr masa për eliminimin e kushteve të papajtueshmërisë dhe informon Këshillin Drejtues për këtë situatë.

12. Raportimi pranë Këshillit Drejtues

- 12.1 Komisioni Disiplinor harton një raport të veprimtarisë vjetore, i cili i dërgohet për miratim Këshillit Drejtues.
- 12.2 Kur është e kërkueshme, Raporti i Komisionit Disiplinor i miratuar nga Këshilli Drejtues i paraqitet për shqyrtim Bordit të Mbikëqyrjes Publike brenda afateve dhe sipas praktikës së ndjekur nga Bordi (si rregull brenda datës 15 mars të vitit pasardhës).
- 12.3 Raporti duhet të përmbajë të paktën elementët si në vijim:
- Një përshkrim për aktivitetin e kryer dhe rastet e shqyrtuara gjatë periudhës raportuese;
 - Rastet kur është shkelur ligji, aktet e detyrueshme të BMP-së, rregulloret, rregullat, vendimet e BMP-së dhe standardet e profesionit;
 - Dobësitë dhe neglizhencat e konstatuara në lidhje me subjektin e investigimit;
 - Propozimet dhe rekomandimet që parashikohen të ndërmerren në të ardhmen.

VI. PROCESI I INVESTIGIMIT

1. Mënyrat e nisjes së procedurës së investigimit

1.1 Rastet kur do të nisë procesi i investigimit do të jenë sipas qasjeve të mëposhtme:

- a) **Qasja e bazuar në ankesat:** Investigimi nis si rrjedhojë e marrjes së një ankese nga një subjekt ndaj kujtdo subjekti të investigimit nga Komisioni Disiplinor;
- b) **Qasja e bazuar në informacione të tjera – jo ankesë:** Investigimi nis me autorizim të Këshillit Drejtues për Komisionin Disiplinor, si rrjedhojë e marrjes së informacionit nga palë të jashtme apo palëve të tjera që nuk janë ankimuese sipas pikës (a)) më sipër, për të cilat vihet në dijeni Këshilli Drejtues apo të cilat njoftohen pranë Këshillit Drejtues apo Shoqatës në rrugë zyrtare, për shkelje të mundshme nga subjektet e investigimit;
- c) **Qasja me kërkesë të BMP-së:** Investigimi nis si rrjedhojë e kërkesës/autorizimit të BMP-së drejtuar Shoqatës.

1.2 Mbështetur në tri qasjet e mësipërme, Komisioni Disiplinor nis procedurat e investigimit dhe shqyrtimit të evidencave. Nëse e vlerëson të nevojshme dhe të dobishme për procesin, Komisioni Disiplinor paraqet kërkesë pranë Këshillit Drejtues për të përfshirë në procedurat investigative anëtarë të tjerë të Shoqatës.

1.3 Këshilli Drejtues, brenda një jave kalendarike nga marrja e kërkesës sipas pikës 1.2 më sipër, autorizon anëtarë të tjerë të Shoqatës të marrin pjesë në procedurën investigative nën udhëzimet e Komisionit Disiplinor.

1.4 Komisioni Disiplinor shprehet me vendim mbi rastin objekt investigimi brenda 30 ditëve kalendarike nga paraqitja e ankesës, autorizimit të Këshillit Drejtues ose paraqitjes së kërkesës së BMP-së për iniciimin e investigimit kundër anëtarit subjekt i investigimit.

1.5 Kur për zhvillimin e plotë të investigimit nevojitet më shumë kohë se afati i parashikuar në pikën 1.4 më sipër, Komisioni Disiplinor paraqet kërkesë të argumentuar pranë Këshillit Drejtues për zgjatjen e këtij afati, i cili nuk mund të shtyhet më shumë se 60 ditë kalendarike

nga paraqitja e ankesës, autorizimit të Këshillit Drejtues ose paraqitjes së kërkesës së BMP-së.

2. Investigimi në bazë ankese

2.1 Komisioni Disiplinor ka të drejtën të shqyrtojë ankesat e ngritura nga palët e treta për anëtarët e Shoqatës, si dhe të drejtën e shqyrtimit të të gjitha ankesave apo informacioneve të tjera, që lidhen me investigimin dhe disiplinën, që vijnë pranë SH.K.F.SH. në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregulloret e miratuara nga BMP-ja, pa rënë ndesh me dispozitat e kësaj rregulloreje.

2.2 Në rastet kur investigimi lidhet me anëtarët pasivë (jo ushtrues) Komisioni nuk angazhohet dhe shqyrtimi i çështjes bëhet drejtpërdrejt në BMP. Të njëjtat kërkesa zbatohen edhe për personat që janë angazhuar apo mund të kenë qenë angazhuar si inspektorë të brendshëm apo ekspertë të jashtëm të BMP-së, në çfarëdolloj forme, deri në tri vite pasi të kenë ndërprerë marrëdhënien me BMP-në.

2.3 Ankesat e ardhura në Shoqatë, drejtpërdrejt apo nëpërmjet BMP-së, duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të përmbajnë të dhëna të rëndësishme, për fakte dhe rrethana të ekzistencës së një sjellje të keqe, mbi të cilën mund të gjykohet për kryerjen e një procesi investigimi.

2.4 Ankesa duhet të përmbajë minimalisht këto elemente:

- Të dhëna mbi ankuesin, të identifikuar në mënyrë të qartë;
- Të dhëna mbi Kontabilistin e Miratuar ose shoqërinë e auditimit objekt i ankesës;
- Përshkrimin e shkeljeve të supozuara apo rrethanave konkrete të pretenduara dhe kohën e ndodhjes së tyre;
- Dokumentet apo burimet mbështetëse të fakteve apo rrethanave të pretenduara.

2.5 Gjatë procesit investigativ, ankimuesi mund të plotësojë dokumentacionin mbështetës me dokumente të tjera që ai i gjykon të arsyeshme, si edhe me dokumentacione të tjera që mund t'i kërkojnë nga Komisioni Disiplinor në funksion të procesit të investigimit.

2.6 Komisioni Disiplinor ruan konfidencialitetin e plotë të të dhënave të ankimuesit deri në mbledhjen e evidencave dhe fakteve, të cilat janë të domosdoshme për të arritur në një konkluzion.

2.7 Komisioni Disiplinor ruan konfidencialitetin e plotë të të dhënave të ankimuesit kur një gjë e tillë kërkohet prej ankimuesit i cili paraqet argumente bindëse për këtë kërkesë, por që, në këtë rast, nuk merr pjesë në seancën dëgjimore që zhvillohet në përputhje me parashikimet në këtë rregullore.

2.8 Rastet e përgjithshme kur ankesat vijnë të paidentifikuara nuk do të konsiderohen me përjashtim të atyre rasteve kur natyra e informacionit është e tillë që vihet në rrezik interesi publik dhe cenohet mënyra e organizimit dhe e veprimtarisë së profesionit. Në këto raste, Komisioni Disiplinor kërkon informacion shtesë në mënyrë të pavarur në rrugë ligjore dhe

mbas mbledhjes së fakteve paraprake mund të propozojë nisjen e një procesi investigimi në përputhje me këtë rregullore.

3. Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave

3.1 Ankesat ndaj KM-ve, ose shoqërive të kontabilitetit, regjistrohen në sekretarinë e Shoqatës nën kujdesin e Drejtorit Ekzekutiv.

3.2 Ankesat e depozituara në SH.K.F.SH. i përcillen për shqyrtim brenda 3 ditëve pune nga data e depozitimit të ankesës, kryetarit të KID dhe njëkohësisht informohet Kryetari i Këshillit Drejtues.

3.3 Kryetari i Komisionit Disiplinor, brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes së njoftimit për ankesën, thërret mbledhjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e saj.

3.4 Komisioni Disiplinor, në mbledhjet e organizuara për shqyrtimin e ankesave, merr vendim lidhur me:

- a) Autorizimin e fillimit të investigimit;
- b) Caktimin e anëtarit apo grupit të punës që do të kryejnë investigimin;
- c) Lëndën objekt verifikimi;
- d) Detyrat e verifikimit;
- e) Dokumentacionin shtesë që mund të kërkohet për kryerjen e investigimit;
- f) Afatin e kryerjes së verifikimit.

3.5 Përfundimi i verifikimit të ankesës nga Komisioni Disiplinor bëhet jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga dita e fillimit të procesit të investigimit. Ky afat mund të shtyhet nga Kryetari i Këshillit Drejtues mbi bazën e kërkesës së Kryetarit të Komisionit Disiplinor dhe vetëm për shkaqe të arsyeshme dhe të argumentuara, pa shkelur afatin e përcaktuar në pikën 1.5 të këtij seksioni.

3.6 Komisioni Disiplinor njofton me shkrim, nëpërmjet Drejtorit Ekzekutiv të SH.K.F.SH., palët e përfshira në proces dhe ato të interesuara/lidhura për procesin investigativ dhe zhvillimin e seancës dëgjimore që mbahet për rastin në investigim.

4. Investigimi mbi bazën e informacioneve të tjera - jo ankesë

4.1 Në rastet kur Këshilli Drejtues i SH.K.F.SH. disponon informacione të marra nga burime të sigurta, që tregojnë për mundësinë e sjelljes së keqe (të papajtueshme) të anëtarit apo anëtarëve të Shoqatës, ai autorizon Komisionin Disiplinor për fillimin e procesit të investigimit.

- 4.2 Investigimi mbi bazën e informacioneve – jo ankesë mund të kryhet si për veprimtarinë e drejtpërdrejtë profesionale, ashtu edhe për çështjet që lidhen me zbatimin e detyrimeve të tjera si anëtar i SHKFSH-së.
- 4.3 Për investigimet mbi bazën e informacioneve – jo ankesë, koha dhe afatet duhet të përcaktohen në autorizimin e investigimit të dhënë nga Këshilli Drejtues. Ky afat mund të shtyhet nga Këshilli Drejtues bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komisionit Disiplinor, vetëm për shkaqe të arsyeshme e të argumentuara.

5. Investigimi me kërkesë të BMP

- 5.1 Investigimi mund të fillojë edhe në bazë të informacioneve, kërkesës apo autorizimit të BMP-së.
- 5.2 Fillimi i investigimit dhe i procesit disiplinor nga ana e Shoqatës kundër subjektit të investigimit, të iniciuara me kërkesë të BMP-së, vendoset nga Këshilli Drejtues, i cili autorizon Komisionin Disiplinor për fillimin e investigimit, duke ndjekur procedurën dhe rregullat në këtë rregullore.
- 5.3 Në mbyllje të procesit të investigimit sipas këtij seksioni, Komisioni Disiplinor, me vendim të Këshillit Drejtues, dorëzon pranë KIDB dhe vë në dijeni BMP-në lidhur me të gjitha gjetjet dhe shmangiet që kanë ndodhur duke adresuar edhe rekomandimet që lidhen me masat disiplinore. Propozimi përfundimtar bëhet nga KIDB.

6. Kryerja e investigimit dhe vendimet e Komisionit

- 6.1 Për të përmbushur misionin e tij, Komisioni Disiplinor nëpërmjet Kryetarit të Këshillit Drejtues, ka të drejtë t'u kërkojë anëtarëve, firmave anëtare dhe palëve të treta informacionet dhe dokumentacionin e nevojshëm për të arritur në konkluzionet e duhura për çështjen që investigohet.
- 6.2 Komisioni Disiplinor ka përgjegjësinë e trajtimit të sigurt dhe konfidencial të dokumenteve dhe evidencës që merr nga palët, e veçanërisht për mbrojtjen e interesave të ankuesit dhe të anëtarit subjekt ankimimi, si dhe informacionin e çdo pale tjetër në përputhje e në zbatim të parimeve të mira në këtë drejtim dhe parashikimeve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, rregulloreve dhe akteve të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- 6.3 Komisioni Disiplinor gjatë kryerjes së procesit investigativ duhet të testojë nëse sjellja e anëtarit (apo e shoqërisë anëtare) ka dështuar të jetë në përputhje me parimet, detyrat, përgjegjësitë dhe standardet ligjore dhe rregullative që ndjek Shoqata, duke marrë parasysh rrethanat, në të cilat kanë ndodhur apo rrjedhur ngjarjet, dhe nëse subjekti i investigimit ka dhënë përpjekjet më të mira në realizimin e detyrave profesionale.
- 6.4 Anëtarët e SHKFSH-së duhet të bashkëpunojnë në proceset e investigimit dhe t'u përgjigjen në kohë të arsyeshme të gjitha komunikimeve të bëra nga Komisioni Disiplinor. Anëtarët, të

cilët nuk bashkëpunojnë apo nuk u përgjigjen në kohë komunikimeve të Komisionit, u nënshtrohen sanksioneve të parashikuara për rastet e shkeljeve etike (sjellje profesionale).

6.5 Në përfundim të procesit të investigimit, Komisioni rishikon të gjithë evidencën dhe faktet e grumbulluara dhe mblidhet për të marrë vendim, i cili duhet të përmbajë edhe mendimin e Komisionit nëse ka (ose jo) fakte apo rrethana që mund të çojnë në iniciimin e një procesi disiplinor ndaj anëtarit/ëve të përfshirë.

6.6 Vendimi i Komisionit Disiplinor duhet të shoqërohet me një relacion përshkrues, i cili duhet të përmbajë, minimalisht, elementet që vijojnë:

- objektin e verifikimit;
- pretendimet e ngritura nga ana e ankuesit (për investigimet e iniciuara në bazë ankese);
- pretendimet apo arsyetimet e mundshme të subjektit të investigimit;
- referencë të dokumenteve, faktet dhe rrethanat që përbëjnë shkelje në referim të ligjit dhe standardeve profesionale;
- përmbledhjen e të dhënave kryesore të rastit të verifikuar;
- përfundimet, nëse ekzistojnë, në rastin konkret shkelje të ligjit, të standardeve teknike, profesionale dhe të kërkesave etike, si dhe vlerësimin nëse ato përbëjnë ose jo shkaqe të arsyeshme për marrjen e masave disiplinore;
- propozimin lidhur me trajtimin e mëtejshëm të verifikimit.

7. Të drejtat dhe përfaqësimi i subjektit të investigimit

7.1 Në rastet kur nis investigimi sipas dispozitave të kësaj rregulloreje, për të garantuar objektivitetin e procesit dhe për të shmangur çdo gjykim subjektiv, anëtarët subjekt i investigimit kanë të drejtën të kërkojnë që ky investigim të kryhet nga KIDB. Në këtë rast, Komisioni Disiplinor pezullon përkohësisht investigimin dhe e pushon atë pasi vihet në dijeni që KIDB pranon zyrtarisht iniciimin e investigimit dhe shqyrtimin e rastit.

7.2 Në rastet kur KIDB nuk pranon të iniciojë investigimin si parashikohet në pikën 7.1 më sipër, apo SH.K.F.SH. autorizohet nga BMP të investigojë rastin, Komisioni Disiplinor vijon me investigimin dhe shqyrtimin e rastit.

7.3 Në kryerjen e investigimit, Komisioni Disiplinor udhëhiqet nga parimi i pjesëmarrjes së anëtarit të përfshirë në çështjen që investigohet, nëpërmjet vënies në dijeni, dëgjimit dhe verifikimit të pretendimeve të tij dhe të trajtimit të tij në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë. Në procesin e investigimit, anëtari subjekt ankimimi mund të asistohet nga një këshilltar ose nga një avokat.

7.4 Kur e gjykon të nevojshme, Komisioni Disiplinor organizon seanca dëgjimore të palëve të përfshira në procesin investigativ.

7.5 Përpara marrjes së vendimit, KID organizon të paktën një seancë dëgjimore të palëve të përfshira në procesin investigativ.

- 7.6 Njoftimi për organizimin e seancës dëgjimore dërgohet me shkrim të paktën 5 ditë përpara organizimit të saj.
- 7.7 Palët e përfshira në procesin investigativ kanë të drejtë që gjatë seancave dëgjimore të asistohen dhe/ose të përfaqësohen nga një këshilltar ose nga një avokat. Në rastet e delegimit të së drejtës së përfaqësimit te persona të tretë, ata duhet të paraqesin një prokurë të posaçme për të drejtën e përfaqësimit.
- 7.8 Drejtuesi i seancës është si rregull Kryetari i Komisionit Disiplinor dhe në mungesë apo në pamundësi të tij një nga anëtarët e Komisionit. Drejtuesi i seancës, përpara se të fillojë seanca dëgjimore, shqyrton kërkesat paraprake që mund të kenë palët.
- 7.9 Shqyrtimi i pretendimeve në seancë dëgjimore fillon duke parashtruar nga ana e drejtuesit relacionin mbi faktet e pretendimet e paraqitura pranë Komisionit dhe të siguruarat prej Komisionit pas fillimit të investigimit. Pasi mbaron relatimi i mësipërm, fjala i jepet ankimesit për të dhënë sqarime më të hollësishme, dhe më pas subjektit të investigimit (ose avokatit/përfaqësuesit të tij), i cili parashtron lidhur me rastin.
- 7.10 Çdo anëtar i Komisionit Disiplinor ka të drejtë të pyesë palët dhe të kërkojë sqarime lidhur me pretendimet e ngritura dhe mbi çështjen.
- 7.11 Nëse në seancën dëgjimore, subjekti i investigimit dhe/ose avokati/përfaqësuesi i tij, nuk paraqitet pa shkaqe të justifikuara, seanca dëgjimore anulohet dhe Komisioni merr vendim bazuar në investigimin e realizuar në përputhje me këtë rregullore.

8. Mosfillimi dhe pezullimi i procedurës së investigimit dhe disiplinës

- 8.1 Komiteti Disiplinor nuk mund të marrë në shqyrtim ankesat, dhe, nëse ka filluar procedura e investigimit bazuar në ankesë, duhet të pezullojë në mënyrë të menjëhershme investigimin në këto raste:
 - Kur për çështjen objekt shqyrtimi procedimi disiplinor është duke u kryer një proces gjyqësor penal ose civil. Në një rast të tillë, vendimi që do të merret nga trupi gjyqësor, pasi të ketë marrë formë të prerë, është detyrimisht i pranuar nga Komiteti Disiplinor.
 - Kur objekti i paraqitur nga ana e subjektit ankimes përbën veprë penale sipas dispozitave të Kodit Penal në Republikën e Shqipërisë. Denoncimin pranë organeve kompetente në një rast të tillë mund ta bëjë vetëm subjekti ankimes.
 - Kur verifikimi i çështjes së paraqitur për ankimes kërkon ekspertizë të posaçme dhe që mund të realizohet vetëm nga organe të specializuara.

9. Dosjet dhe dokumentimi i investigimit dhe masave disiplinore

- 9.1 Për secilin rast të investiguar mbahet një dosje sipas një modeli të caktuar nga Komisioni Disiplinor dhe administrohet/arkivohet nga Drejtori Ekzekutiv, e cila përmban të gjithë dokumentet përkatëse që kanë lidhje me rastin. Kjo dosje përmban detyrimisht të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë procesit investigues, që nga fillimi i tij deri në përfundim të procesit, ku përfshihet edhe vendimi i Këshillit Drejtues për rastin.
- 9.2 Për secilën mbledhje të Komisionit Disiplinor mbahet një procesverbal për rastin objekt investigimi, ku pasqyrohet data, vendi, rendi i ditës, anëtarët pjesëmarrës në mbledhje,

drejtuesi i saj, çështjet që janë diskutuar, forma dhe rezultati i votimeve. Në fund të mbledhjes, procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm.

- 9.3 Për secilin rast të investiguar mbahet një dosje sipas një modeli të caktuar nga Komisioni Disiplinor dhe menaxhohet nga Drejtori Ekzekutiv, e cila përmban të gjithë dokumentet përkatëse që kanë lidhje me rastin. Kjo dosje përmban detyrimisht të gjithë dokumentacionin e administruar gjatë procesit investigues, që nga fillimi i tij deri në përfundimin e procesit.
- 9.4 Dosjet me të gjithë dokumentet e referuara në pikat 9.1, 9.2 dhe 9.3 më sipër, ruhen për një periudhë dhjetëvjeçare.
- 9.5 Drejtori Ekzekutiv është përgjegjës për marrjen në kohë të të gjitha masave për asistimin e Komisionit Disiplinor në çështjet administrative, sekretariale dhe logjistike.

10. Asgjësimi i dokumentacionit lidhur me procesin e investigimit dhe disiplinës

- 10.1 Dokumentet që përgatiten lidhur me procesin e investigimit dhe disiplinës dorëzohen dhe ruhen në fund të çdo procesi në arkivin e Shoqatës për një periudhë dhjetëvjeçare, në përputhje me politikat e saj për ruajtjen e dokumentacionin.
- 10.2 Në përfundim të periudhës në pikën 10.1, bëhet asgjësimi i dokumentacionit në praninë e Komisionit Disiplinor. Deri në asgjësimin e tyre, informacioni konfidencial ruhet në kasafortë ose në një raft të mbyllur metalik që garanton mjaftueshmërisht sigurinë e informacionit.

VII. SJELLJET E PAPAJTUESHME

1. Sjelljet e papajtueshme

1.1 Me shkelje ose sjellje të papajtueshme do të nënkuptohet:

- a) çdo aktivitet kriminal
- b) çdo veprimtari apo shkelje, të cilat cenojnë integritetin dhe imazhin e profesionit kontabël;
- c) rastet e neglizhencës profesionale të përsëritur
- d) shkelje ose shmangiet nga rregullat, rregulloret dhe standardet profesionale teknike dhe shkelje të:
 - kërkesave ligjore të Ligjit “Për Auditimin”;
 - akteve ligjore që lidhen me ushtrimin e profesionit;
 - akteve rregullatore të BMP;

- rregulloreve të brendshme të Shoqatës, të cilat miratohen nga BMP;
 - Kodit të Etikës të Shoqatës (në pajtueshmëri të plotë ose të njëjtë me Kodin e Etikës së Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC)).
- e) Çdo rast tjetër i parashikuar në pikën 5 (iv) të Seksionit I të kësaj Rregulloreje.

VIII. SHQYRTIMI NGA KËSHILLI DREJTUES

1. Shqyrtimi i relacionit dhe i propozimit të Komisionit Disiplinor

- 1.1 Në përfundim të një procedure investigimi, Komisioni Disiplinor harton një relacion shpjegues dhe të arsyetuar, ku jepet edhe mendimi i Komisionit për vendimin që duhet marrë. Kur ka mendime të ndryshme mes anëtarëve, relacioni shpjegues përmban edhe mendimin e pakicës së anëtarëve të Komisionit.
- 1.2 Relacioni, së bashku me propozimin për masën që duhet marrë, i dërgohet për shqyrtim Këshillit Drejtues të SHKFSH, i cili, kur e konsideron investigimin të plotë, njofton për këtë Komisionin dhe shprehet me vendim për rastin jo më vonë se 40 ditë kalendarike nga data e marrjes së njoftimit.

- 1.3 Kur relacioni që shoqëron propozim e Komisionit nuk është i plotë dhe mjaftueshmërisht i argumentuar, KD e kthen çështjen për rishqyrtim pranë Komisionit dhe përcakton edhe afatet e këtij rishqyrtimi. Pas plotësimit të mangësive, Këshilli Drejtues merr vendim brenda afatit të përcaktuar në pikën 1.2.
- 1.4 Kur relacioni shpjegues çmohet i plotë dhe evidencat e konsideruara në relacion të mjaftueshme për të vlerësuar rastin, Këshilli Drejtues njofton Komisionin dhe shprehet me vendim të arsyetuar mbi rastin brenda afatit në pikën 1.2 më sipër.

2. Vendimet e Këshillit Drejtues mbi investigimin

- 2.1 Kur me vendim Këshilli Drejtues ka vendosur të ngarkojë me përgjegjësi profesionale anëtarin e SH.K.F.SH., dosja e investigimit që përmban rezultatet e verifikimeve dhe relacionin e Komisionit Disiplinor, së bashku me vendimin e Këshillit, në të cilin është kategorizuar shkelja, i kalojnë për gjykim BMP-së për masa disiplinore.
- 2.2 Për rastet e investiguara mbi bazë ankese, për të cilat Këshilli Drejtues ka vendosur të mos ngarkojë me përgjegjësi profesionale, vendimi i Këshillit Drejtues së bashku me relacionin shpjegues të Komisionit, i përcillen si informacion BMP-së.
- 2.3 Kur gjykohet e nevojshme, Këshilli Drejtues, përpara se të marrë vendim si në pikat 2.1 dhe 2.2, merr një opinion ligjor mbi çështjen nga ekspertë të brendshëm ose të jashtëm të fushës, duke u kujdesur për respektimin e afatit të parashikuar në pikën 1.2 të Seksionit VIII (1).
- 2.4 Për të gjitha rastet e investiguara, për të cilat Këshilli Drejtues ka marrë vendim të kalojë për gjykim rastin pranë BMP për masa disiplinore, dosja e investigimit që përmban rezultatet e verifikimeve, evidencat e përcaktuara në këtë rregullore dhe relacionin e Komisionit Disiplinor, së bashku me vendimin e Këshillit Drejtues, ruhen dhe dokumentohen pranë Shoqatës nën kujdesin e Drejtorit Ekzekutiv.

3. Masat ndaj kontabilistëve të miratuar dhe shoqërive të kontabilitetit

- 3.1 Për rregullimin e profesionit të kontabilistit të miratuar ndaj anëtarëve subjekt i investigimit do të zbatohen masat e mëposhtme:
- a. Rekomandim për përmirësim;
 - b. Vërejtje dhe rekomandim për përmirësim të Kontabilistëve të Miratuar pa shënim në regjistrin publik të organizatave profesionale në fushën e kontabilitetit;
 - c. Vërejtje për Kontabilistët e Miratuar me shënim në regjistrin publik të organizatave në fushën e kontabilitetit;
 - d. Pezullim të përkohshëm të Kontabilistëve të Miratuar, për një kohë jo më shumë se pesë vite;

- e. Fshirje e përhershme e Kontabilistëve të Miratuar nga të gjithë regjistrat publikë të organizatave profesionale, e cila përmban ndalimin përgjithmonë të ushtrimit të profesionit.
- 3.2 Masa administrative e përcaktuar në shkronjën “a” dhe “b” të pikës 3.1 jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “c” të pikës 3.1 të këtij seksioni dhe kanë një natyrë rekomanduese ose shmangie, e cila mund të përmirësohet pa krijuar shkelje ligjore.
- 3.3 Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni jepet në rastet kur shkelja e konstatuar nuk plotëson kriteret për marrjen e masave disiplinore të parashikuara në shkronjat “d”, “e” të njëjtës pikë. Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “c” jepet për rastet në vijim:
- a. Rastin e mosdhënies së informacionit apo dokumentacionit të kërkuar nga autoritetet përgjegjëse, në kuadër të procesit që mund të lidhet me kontrollet e cilësisë të ndërmarra nga BMP-ja;
 - b. Kur ka mungesë të një kontrate, në të cilën detajohen termat e angazhimit dhe përgjegjësitë e palëve;
 - c. Kur ka shkelje të kodit të etikës në Kodin e Etikës së Organizatave Profesionale (të cilat duhet të jenë në pajtueshmëri të plotë ose të njëjtë me Kodin e Etikës së Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC)).
- 5.4 Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “d” të pikës 3.1 të këtij seksioni, jepet në rastet kur:
- a. Ka përsëritje të shkeljes, më shumë se dy herë, të rasteve të parashikuara në pikën 3.3 më sipër;
 - b. Kontabilisti i miratuar apo shoqëria e kontabilitetit, gjatë funksioneve të veta, kryen edhe funksionin e auditimit ligjor (të dokumentuar përmes raporteve apo kontratave të angazhimit apo evidencave të tjera që provojnë kryerjen e shërbimit).
 - c. Ka mospërputhje të konsiderueshme ndërmjet deklaramit vjetor të kohës, sipas angazhimeve të kryera dhe kohës në dispozicion të llogaritur, duke mbajtur parasysh bashkëpunëtorët dhe të punësuarit e deklaruar.
- 5.5 Masa disiplinore e përcaktuar në shkronjën “e” të pikës 1 të këtij Seksioni, jepet në rastet kur:
- a. kontabilistët e miratuar dhe shoqëritë e kontabilistëve të miratuar përfshihen në shërbime të hartimit të pasqyrave financiare qëllimisht të deformatuara, duke mbajtur paralelisht dy lloje kontabiliteti me qëllimin për manipulimin e qëllimshëm të pasqyrave financiare. Nuk përbëjnë deformim të qëllimshëm rastet kur pasqyrat mbahen sipas disa kuadrove të ndryshëm të raportimit (SNRF, SKK, Kuadri Raportimit të Grupit apo ndonjë kuadri raportimi të brendshëm të organizatës/entitetit) apo për qëllime të lidhura me kontabilitetin e kostos dhe atë menaxherial, apo hartimi i pasqyrave apo raporteve të ndërmjetme, të cilat janë vetëm për qëllime të brendshme ose të grupit.
 - b. Shkeljet e përcaktuar në pikën 3.4 të këtij seksioni përsëriten më shumë se dy herë.

- 3.6 Për të siguruar barazi në procesin e disiplinës dhe që masat e ndërmarra të jenë në proporcion me nivelin e sjelljes së papërshtatshme, merren në konsideratë të gjitha rrethanat e rastit duke përfshirë:
- Ndonjë faktor që e thellon më shumë ose e zvogëlon rastin në fjalë;
 - Rrethana personale të individit dhe të ndonjë personi tjetër që mund të zvogëlojë rrethanat për individin ose shoqëritë, p.sh. rrethana që i takojnë deri në datën e marrjes së vendimit;
 - Ndonjë referencë të siguruar për të mbështetur audituesin ligjor/shoqërinë e auditimit ose njësinë ekonomike.
- 3.7 Pavarësisht nga sa parashikuar në këtë seksion, mospërmbushja e detyrimeve të kualifikimit të vijueshëm në përputhe me kërkesat ligjore dhe rregulloren për edukimin e vijueshëm dhe praktikën profesionale të miratuara nga BMP-ja dhe që ndiqen nga Shoqata, përbëjnë arsye për mosregjistrimin e kontabilistëve të miratuar në listën e publikueshme të kontabilistëve të miratuar në përputhje me rregullat dhe aktet e miratuara nga BMP për kualifikimin e vijueshëm profesional.

4. Masat ndaj kandidatëve për Kontabilist i Miratuar

- 4.1 Për shkeljen e standardeve profesionale të akteve dhe rregulloreve të Shoqatës apo të dispozitave ligjore nga kandidatët për Kontabilist i Miratuar, Komisioni Disiplinor i propozon Këshillit Drejtues marrjen e masave disiplinore si vijon:
- Qortim;
 - Vërejtje me shkrim;
 - Përrjashtim nga Shoqata.
- 4.2 Këshilli Drejtues shqyrton dhe merr vendim përfundimtar ndaj kandidatit për Kontabilist i Miratuar.

XI. EVIDENCAT DHE DOKUMENTIMI I TYRE

1. Pranimi i provave

- 1.1 Për qëllime të marrjes së masave disiplinore ose jo, do të përdoren vetëm ato që quhen evidenca, të cilat ligjërisht pranohen në gjykatë, që për qëllim të kësaj rregulloreje do të bëhet një përkufizim dhe përcaktim i përgjithshëm pa u limituar vetëm në to.
- 1.2 Për qëllime të investigimit dhe hapjes së një çështjeje investigimi, Komisioni Disiplinor mund të përdorë edhe evidenca, të cilat jo domosdoshmërisht përbëjnë një fakt ligjor, megjithatë informacioni i siguruar prej tyre, objektivisht dhe arsyeshmërisht, gjykohet nga Komisioni apo Këshilli Drejtues se ndihmon në vlerësimin e çështjes.
- 1.3 Në listën e evidencave që pranohen, por pa u limituar vetëm në to, janë:

- a. Raportet e nënshkruara dhe të vulosura zyrtarisht nga subjektet e investigimit, të cilat janë të publikuara zyrtarisht, me kushtin që të mos jenë të falsifikuara apo të krijuara në keqpërdorim.
- b. Intervistat, të cilat janë të regjistruara me aprovim të subjektit apo të cilat dokumentohen përmes një procesverbali, i cili nënshkruhet nga subjekti;
- c. Komunikimi përmes postës elektronike me kushtin që adresa e email-it është e autorizuar dhe është nënshkruar prej subjektit që kjo adresë shërben edhe si evidencë zyrtare. Në rast të ndryshimit të adresës elektronike, subjekti duhet të vërë në dijeni organizatën profesionale apo/dhe BMP-në sipas rasteve;
- d. Çdo dokumentacion zyrtar, i cili përpilohet dhe dorëzohet nga subjekti i investiguar (p.sh., faturë, pasqyra financiare etj.);
- e. Evidenca statistikore, të cilat përdoren nga inspektorët për të krahasuar të dhënat faktike me ato të lejuara;
- f. Të tjera evidenca të pranuar nga legjislacioni në fuqi.